

Pyetje & Përgjigje të kombinuara
Për Thirrjen e Hapur për Projekt-Propozime për Organizatat Jofitimprurëse
"Recraft the Past: Build Up the Future"
(CFP 02-2022)

Ky dokument shërben si regjistër i sqarimeve të dhëna palëve të interesuara në lidhje me Thirrjen e Hapur për Projekt-Propozime për Organizatat Jofitimprurëse "Recraft the Past: Build Up the Future" (CFP 02-2022) në përgjigje të kërkesave të tyre të marra brenda afatit të caktuar për paraqitjen e kërkesave. Pyetjet u pranuan përmes kanaleve të ndryshme të përcaktuara në Udhëzimet e kësaj Thirrje, duke përfshirë ato verbale gjatë sesioneve informuese të EU4Culture në lidhje me Thirrjen, përmes emailëve me shkrim, si dhe gjatë takimeve dhe telefonatave. Përgjigjet e pyetjeve të marra janë përmbledhur në këtë dokument.

Q. A ka përqindje apo limit mbi aspektin e Burimeve Njerëzore apo kostove administrative?

A. Kjo Thirrje nuk parashikon një limit mbi buxhetimin e kostove të burimeve njerëzore. Megjithatë, gjatë vlerësimit të zbatimit të kriterit të Efektivitetit të Kostove e në harmoni edhe me kriteret e tjera të vlerësimit, buxheti i kostove të punonjësve pritet të vlerësohet rast pas rasti, në varësi të natyrës së projekt-propozimit e në përputhje me praktikën e mira të buxhetimit financiar. Për këtë qëllim, praktikë e mirë do të konsiderohet ajo që parashikon një buxhetim racional të këtyre kostove në masën rreth 20% të buxhetit total të projektit. Për efekt buxhetimi në këtë Thirrje, burimet njerëzore nuk përfshijnë tarifën e ekspertëve; këto të fundit, vetëm kur janë të domosdoshme, duhen paraqitur si zëra të veçantë në buxhet e të justifikohen përkatësisht.

Q. A mund të vazhdojnë programe që janë aktualisht në zbatim? A ka mundësi të vazhdimin të projektit edhe pas përfundimit të kontratës?

A. Në kuadër të kësaj Thirrjeje do të merren në shqyrtim të gjithë projekt-propozimet që plotësojnë kriteret e përcaktuara në Udhëzues. Aktivitetet mund të pasojnë apo edhe të jenë të ndërlidhura me ato të projekteve të tjera. Megjithatë, në rast se një projekt-propozim është në vazhdim të një projekti ekzistues apo është pjesë e një programi i cili pritet të vazhdojë edhe përtej datës përfundimtare të marrëveshjes, dallimi ndërmjet fazave duhet të jetë i qartë si dhe ai do trajtohet si projekt më vete edhe për sa i përket komunikimit, promovimit, monitorimit e raportimit të tij (si narrativ, ashtu edhe financiar). Në çdo rast, shpenzimet e kryera përpara fillimit të marrëveshjes me UNOPS apo pas përfundimit të saj, nuk do të financohen nga ky grant. Po kështu, fondet nga kjo Thirrje nuk mund të përdoren për aktivitete të financuara nga burime të tjera financimi.

Q. A përfshihen tour operators në këtë thirrje?

A. Organizatat aplikante apo partnere në këtë Thirrje duhet të përmbajnë përkufizimin **organizatë jo-fitimprurëse** në Statut dhe në Aktin juridik të Regjistrimit në gjykatë si edhe të plotësojnë kriteret e tjera në mënyrë që aplikimet e tyre të merren në konsideratë për vlerësim. Operatorët turistikë zakonisht janë subjekte private me *qëllim fitimi* e si të tillë nuk mund të përfshihen si aplikantë e nuk mund të jenë përfitues grantesh nga kjo Thirrje. Kompanitë që mund t'u ofrojnë shërbime organizatave jo-fitimprurëse mbi baza komerciale mund të përshihen në zbatimin e projektit vetëm si ofrues shërbimi.

Q. A mund të jetë pushteti lokal partner në një aplikim?

A. Institucionet e pushtetit vendor (bashki, këshilla qarqesh, prefektura, e të tjera) si edhe institucionet e dekoncentruara të qeverisjes qendrore nuk mund të jenë as aplikantë, as partnerë zbatues në këtë Thirrje. Ndërkohë, marrëveshjet paraprake të mirëkuptimit apo bashkëpunimit të aplikantit me institucione të tilla mund të konsiderohen si kontribute për rritjen e qendrueshmerisë së projektit e mund të ndikojnë pozitivisht në rezultatin e vlerësimit të projekt-propozimit.

Q. Sa herë mund të aplikojë një organizatë? Sa herë si lead dhe sa herë si partner?

A. Një organizatë mund të paraqesë më shumë se një aplikim, qoftë si aplikant e qoftë si organizatë partnere, por, në rast se më shumë se një nga projekt-propozimet kalon prapë e vlerësimit, organizata do të mund të përfitojë vetëm një grant, qoftë ky si aplikant apo si organizatë partnere.

Q. Deri sa mund të shtrihet rrezja e aksioneve të projekteve? Duhet të lidhet vetëm me objektet e përmendura (të trashëgimisë kulturore) apo edhe në gjithë bashkinë?

A. Projektet që do të financohen përmes kësaj Thirrjeje do t'i ushtrojnë aktivitetet e tyre vetëm brenda kufijve administrativë të katër bashkive të përcaktuara në këtë Thirrje, pra në Durrës, Kavajë, Rrogozhinë e Krujë. Është e mundshme që aktivitetet të zbatohen në më shumë se një territor bashkie, për sa kohë që: a) ato territore janë pjesë e këtyre katër bashkive, DHE b) në projekt-propozim e gjatë zbatimit, në rast financimi, do të demonstron lidhje e qartë me ato objekte të trashëgimisë kulturore ku ka ndërhyrë apo po ndërhyrë EU4Culture e me komunitetet rreth tyre.

Q. Organizata jonë ka zhvilluar disa aplikacione (software), por nuk kanë pasur vazhdueshmëri përtej jetëzgjatjes së projekteve, sidomos lidhur me licencat e pagesat. Si mendohet të zgjidhet teknikisht, vijueshmëria e aplikacioneve të krijuara gjatë projektit?

A. Së pari, ky grant nuk do të financojë shpenzime të kryra përpara fillimit të marrëveshjes me UNOPS-in apo pas përfundimit të saj. Kjo vlen edhe për shpenzimet për zhvillim, implementim apo blerje licencash e të drejtash përdorimi të aplikacioneve.

Së dyti, të drejtat e licencave të produkteve dixhitale, në përfundim të projektit pritet që t'i transferohen përfituesve institucionalë të projektit që janë Ministria e Kulturës ose një institucion varësie i përcaktuar nga Ministria. Deri në përfundim të projektit, ato do t'i përkasin donatorit (EU) ose UNOPS-it, por kjo do të vendoset e do të komunikohet rast pas rasti.

Së treti, përsa i përket vijueshmërisë së funksionalitetit të aplikacioneve dhe/ose në rast nevojë mirëmbajtjes së tyre përtej kohëzgjatjes së projektit, zgjidhja që të jepet në projekt-propozim do të vlerësohet në përputhje me kriterin e Qendrueshmërisë [shiko 10. Evaluation Criteria].

Q. Kur duhet të jetë i regjistruar entiteti përsa i përket kriterit të pranimit?

A. Si aplikanti, ashtu edhe organizata partnere, duhet të jenë regjistruar ligjërisht jo më vonë se 6 muaj përpara afatit për dorëzimin e aplikimeve.

Q. A është 15% limit për të mbuluar kostot e prodhimit të materialeve promocionale për gjithë projektin apo për promocionin e produkteve që do të mbështeten?

A. Kostot për **nën-kontraktimin** e aktiviteteve promocionale nuk mund ta kalojnë 15% të buxhetit total të projektit. Kjo vlen për aktivitetet që planifikohen të kryhen përmes palëve të treta (të regjistruara sipas ligjit si kompani me qëllim fitimi) të cilat kontraktohen për të ofruar shërbime profesionale promocioni përfshirë hartim e prodhim përmbajtjeje dhe materiale. Për sa i përket aktiviteteve ndërgjegjësuere të projektit si dhe shpërndarjen e mesazheve dhe materialeve promocionale, ato do të konsiderohen pjesë integrale e zbatimit të projektit që kryhet nga organizata zbatuese e nuk mund të nën-kontraktohen tek palë të treta.

Q. Cfarë nënkupton limiti 30% kostove për partnerin ?

A. Kostot që do të buxhetohen në kolonën “kostot e partnerit” (shiko Annex C) si edhe shpenzimet financiare që do raportohen nga organizata e cila do të manaxhojë grantin si të kryera nga organizata partnere DHE që pas verifikimit do të pranohen si të lejueshme nga EU4Culture nuk mund të tejkalojnë masën 30% të totalit të pranueshëm të shpenzimeve për cdo zë buxhetor.

Q. A do të zgjerohet në të ardhmen si program edhe në rajone të tjera?

A. Përmes thirrjeve pasuese për projekt-propozime, skema e granteve të EU4Culture do të shtrihet edhe në bashki të tjera të cilat janë pjesë e territoreve të bashkive të prekura nga tërmeti i nëntorit 2019.

Q. Ne jemi një organizatë e re që kemi aplikuar, por nuk kemi arritur të marrim e të zbatojmë grante më parë. Sa mund ta penalizojë eksperiencia dhe jetëgjatësia e një organizate procesin e aplikimit?

A. Në qoftë se një organizatë është regjistruar sipas ligjit më herët se 6 muaj përpara afatit të dorëzimit të aplikimeve dhe plotëson kriteret e tjera, sipas Udhëzuesit [9. General Eligibility Criteria a), b), c) dhe d)], atëherë ajo është e lejueshme që të aplikojë dhe nuk do të përjashtohet nga procesi i aplikimit.

Q. A është një kriter i domosdoshëm bilanci i vitit 2021, pasi vetë procedura për nxjerrjen e tij shkon deri në fundin e muajit Mars?

A. Po, paraqitja e balanceve të vitit të fundit financiar e fiskal, pra të vitit 2021, është kriter i domosdoshëm në përputhje me listën e kontrollit [Annex F].

Q. Në rastin e një projekti që mbështet prodhimet artizanale dhe shitjen e tyre përmes dyqaneve të artizanëve, a mund të përfshihet në buxhet qeraja e dyqaneve?

A. Qeratë e dyqaneve janë kosto që nuk mund të mbulohen nga këto grante, ashtu si edhe kostot e blerjes së lëndës së parë të prodhimit apo kosto të tjera të listuara në Udhëzues [6. Ineligible Costs and Budget Thresholds]

Q. Në cilët afate kohore pritet të ketë një thirrje të dytë?

A. Thirrja e dytë pritet të shpallet përpara vjeshtës së vitit 2022.

Q. Cilat zona do të përfshihen në thirrjen e dytë?

A. Nuk është vendosur akoma përfundimisht. Megjithatë listës së aktiviteteve të lejueshme të projektit pritet t'i shtohen territore bashkish të tjera nga këto të Thirrjes së parë.

Q. A mundet që Bashkia të jetë partner në një aplikim?

A. Bashkitë, si institucione, nuk mund të jenë as aplikantë e as partnerë zbatues në këtë thirrje. Ndërkohë, marrëveshjet paraprake të mirëkuptimit apo bashkëpunimit të aplikantit me institucione të tilla mund të konsiderohen si kontribute për rritjen e qendrueshmerisë së projektit e mund të ndikojnë pozitivisht në rezultatin e vlerësimit të projekt-propozimit.

Q. A mund të paraqitet një aktivitet që do kryejnë në bazë të një marrëveshje me qeverinë për trajnim punësimi me burgun e grave, e dakortësuar me ministrinë përkatëse?

A. Në këtë Thirrje është e lejueshme të paraqiten propozime, objektivi e fusha e zbatimit të të cilave duhet të kontribuojë drejtpërdrejt në arritjen e objektivit kryesor të Thirrjes përmes aktiviteteve që synojnë të arrijnë një ose të dy objektivat specifikë. Mungesa e lidhjes me ndonjë nga objektivat e deklaruara mund të skualifikojë propozimin. Për më tepër, lidhja e aktiviteteve specifike me objektivat e deklaruara të projektit dhe ato të Thirrjes është pjesë e kriterëve të vlerësimit [10. Evaluation Criteria] dhe do të vlerësohet përkatësisht me pikë.

Q. A është e detyrueshme që projekt-propozimi të ketë lidhje me vendndodhjet e listuara në Thirrje? Për shembull, projekt-propozimi ynë do të fokusohet si në kulturën materiale ashtu edhe atë shpirtërore dhe identitetin e komunitetit Rom. Çdo bashki e synuar ka një popullatë Rome, por nuk jemi të sigurt si apo nëse vendndodhjet historike apo arkeologjike lidhen drejtpërdrejt me pakicat Rome.

A: Projekt propozimet pritet të përfshijnë ndërhyrje të cilat duhet të kontribuojnë drejtpërdrejt në arritjen e objektivit të përgjithshëm nëpërmjet aktiviteteve që synojnë të arrijnë një ose të dy objektivat specifikë. Mungesa e lidhjes me ndonjë nga objektivat e deklaruara mund të skualifikojë propozimin nga vlerësimi i mëtejshëm. Lidhjet e drejtpërdrejta ndërmjet përfituesve fundorë dhe ndonjë, disa ose të gjitha vendndodhjeve të ndërhyrjeve dhe institucionet brenda ndonjë, disa ose të gjitha territoreve të katër bashkive nuk janë të detyrueshme, por pritet që ato të deklarohen kudo ku është e mundur, dhe të krijohen dhe qartësohen në masën më të madhe të mundshme. Për më shumë detaje se si do të vlerësohen propozimet, ju lutemi referojuni **Seksionit 10 të Udhëzuesit të kësaj Thirrjeje** [10. Evaluation Criteria]

Q. A mund të aplikojmë si konsorcium?

A: Aplikimet e përbashkëta nga më shumë se një organizatë, në partneritet operacional me organizata të tjera jofitimprurëse të zhvillimit lokal dhe komunitar janë të pranueshme. Në një rast të tillë, projekt propozimet duhet të pasqyrojnë kapacitetet e brendshme të aplikantit dhe të organizatës(-ave) partnere për të kryer aktivitetet e propozuara. Për më shumë detaje mbi formulat e partneritetit dhe çdo kufizim që mund të zbatohet në ndonjë rast, ju lutemi referojuni Udhëzuesit të Thirrjes.

Q. Cilat janë OSHC-të e lejueshme për të aplikuar?

A: Sipas Seksionit 9: [General Eligibility Criteria] të Udhëzuesit të kësaj Thirrjeje, vetëm personat juridikë të regjistruar në përputhje me ligjet në fuqi në Republikën e Shqipërisë si **jofitimprurës** me status aktiv në momentin e aplikimit kanë të drejtë të aplikojnë. Kjo përfshin, por nuk kufizohet, vetëm të gjitha OSHC-të, shoqatat e artizanëve, shoqatat e operatorëve turistikë, shoqatat e biznesit, organizatat e biznesit social (ndërmarrjet sociale), agjencitë rajonale dhe/ose lokale (ekonomike) të zhvillimit, etj. Për një listë më të plotë por jo-shteruese të tipeve të ndryshme të subjekteve të pranueshme, të regjistruara si jofitimprurëse, ju lutemi lexoni të plotë Seksionin 9 të Udhëzimeve të kësaj Thirrjeje

Q. Sa institucione mund të përfshihen?

A: Aplikimet nga më shumë se një organizatë, në partneritet operacional me organizata të tjera janë të pranueshme. Në këtë kuptim, nuk ka një kufi për numrin e organizatave që mund të përfshihen në fazën e aplikimit. Në çdo rast, në projekt propozime duhet të pasqyrohen kapacitetet e brendshme të aplikantit dhe të organizatës(-ave) partnere për të kryer aktivitetet e propozuara.

Më shumë institucione, duke përfshirë agjencitë qeveritare, mund të përfshihen përmes Marrëveshjeve të Mirëkuptimit ose Marrëveshjeve të Bashkëpunimit, megjithatë, për qëllimet e kësaj Thirrjeje, ato nuk do të konsiderohen si organizata partnere dhe përfituesi i mundshëm i grantit nuk duhet të krijojë pritshmëri për menaxhim të përbashkët projekti apo financiar.

Aplikantët kanë gjithashtu mundësinë që t'u japin kontrata nënkontraktorëve për ekzekutimin e detyrave të përcaktuara qartë dhe këta do të zgjidhen përmes një procesi transparent përzgjedhjeje. Për më shumë detaje mbi këto, ju lutemi lexoni me kujdes Udhëzimet e kësaj CFP.

Q. A ka të ngjarë që ky projekt të shtrihet në bashki të tjera?

A: Skema e granteve EU4Culture do të shtrihet edhe në bashkitë e tjera të cilat janë pjesë e territoreve të bashkive të prekura nga tërmeti i nëntorit 2019, përmes thirrjeve të mëpasshme për projekt propozime.

Q. Për sa i përket zbatimit të të gjithë projektit, a do të udhëhiqet ai nga një manaxher i përbashkët për partneritetin?

A. Në rast se jepet një grant për ekzekutimin e një projekt-propozimi të rënë dakord për t'u zbatuar në partneritet operacional me një ent tjetër të pranueshëm, Marrëveshja për Mbështetjen e Grantit (shih modelin GSA në faqen e internetit) do të nënshkruhet vetëm midis UNOPS-it dhe aplikantit kryesor në cilësinë e përfituesit të ardhshëm të grantit. Prandaj, aplikanti kryesor pritet të demonstrojë aftësi menaxheriale dhe financiare për të menaxhuar me sukses projektin dhe për të caktuar burime kyçe e të dedikuara njerëzore, që përfshijnë koordinatorin/menaxherin e projektit dhe punonjësin e financës. Gjatë zbatimit, shpenzimet financiare, qofshin ato të kryera nga Përfituesi i Grantit apo nga organizata partnere, do të nënshkruhen ose bashkë-nënshkruhen dhe do t'i raportohen UNOPS-it nga Përfituesi i Grantit.

Q. Kemi një pyetje lidhur me 4 bashkitë që keni përfshirë:

A duhet që propozimi t'i përfshijë që të 4-a ato, apo mund të përshijmë edhe bashki me përjasje të ngjashme ndaj aktiviteteve me ato të propozimit?

A. Projekt propozimet pritet të përfshijnë ndërhyrje të cilat duhet të kontribuojnë drejtpërdrejt në arritjen e objektivit të përgjithshëm dhe çdonjërit prej dy objektivave specifike në disa ose të gjitha territoret e katër bashkive (Durrës, Kavajë, Rrogozhinë dhe Krujë). Territore të tjera mund të përfshihen vetëm për të ilustruar qasjet e ndërmarra në territoret kryesore të pranueshme, por aktivitetet reale në to, veçanërisht ato që kërkojnë udhëtim dhe akomodim, duhet të mbahen brenda një minimumi të arsyeshëm.

Vini re se sipas **Seksionit 6 [Ineligible Costs and Budget Thresholds]** të Udhëzuesit të kësaj Thirrjeje, aktivitetet që zhvillohen vetëm ose kryesisht në territoret e bashkive të tjera, që nuk janë pjesë e katër bashkive të vendndodhjeve të projektit, do të konsiderohen të papranueshme. Gjithashtu, ju lutemi lexoni me kujdes nën-seksionin **[Budget Thresholds]** si dhe **Seksionin 10 [Evaluation Criteria]**.